

KOSTOJA E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË KOSOVË DHE KURSIMET E MUNDSHME

SHKURT
2022



PRAKTIKA GLOBALE NË FINANCË, KONKURRENCISHMËRI DHE NOVACION

GRUPI PËR ZHVILLIMIN E SISTEMEVE TË PAGESAVE



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Grupi i Bankës Botërore
1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org
paymentsystems@worldbank.org
Telefon: +1 202 473-1000



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org
E-mail: info@bqk-kos.org
Telefon: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Ky studim është produkt i stafit të Bankës Botërore dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore ose qeverive që ata përfaqësojnë.

TË DREJTAT DHE LEJET

Materiali në këtë botim i nënshtrohet të drejtës së autorit. Banka Botërore dhe Banka Qendrore e Republika e Kosovës e inkurajojnë shpërndarjen e njohurive të tyre, prandaj kjo vepër mund të riprodhohet në tërësi ose pjesërisht, për qëllime jotregtare për sa kohë që jepet atribuiimi i plotë.

PËRMBAJTJA

07

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

11

II. QASJA NË PAGESAT ELEKTRONIKE

II.1 KONSUMATORËT.....	11
II.2 BIZNESET.....	13

23

IV. KOSTOT E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL SIPAS AKTERËVE EKONOMIKË

IV.1. KONSUMATORËT.....	23
IV.2. BIZNESET.....	25
IV.3. OFRUESIT E SHËRBIMIT TË PAGESAVE DHE OFRUESIT E INFRASTRUKTURËS SË PAGESAVE.....	26

30

VI. KONKLUZIONE

09

I. METODOLOGJIA

15

III. RRJEDHA E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL SIPAS AKTERËVE

III.1. KONSUMATORËT.....	15
III.1.1 Pagesat e Pranuara.....	15
III.1.2. Pagesat e Iniciuara.....	16
III.2. BIZNESET.....	19
III.2.1. Pagesat e Pranuara.....	19
III.2.2. Pagesat e Iniciuara.....	21

28

V. KOSTOT DHE KËRSIMET PËR EKONOMINË

32

SHTOJCA



TABELAT, FIGURAT DHE KUTITË SHPJEGUESE

Tabela 1: Qasja në llogari bankare, shpërndarja (%) e përgjithshme dhe sipas industrisë dhe biznesit.....	14
Tabela 2: Qasja online në llogari, shpërndarja (%) e përgjithshme dhe sipas industrisë dhe biznesit.....	14
Tabela 3: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar nga industria, madhësia e biznesit dhe instrumenteve të pagesave.....	19
Tabela 4: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara sipas industrisë, madhësisë së biznesit dhe instrumenteve të pagesave.....	21
Tabela 5: Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet (me 50 përqind dhe 100 përqind shkallë konvertimi për raste të ndryshme përdorimi).....	29
Tabela 6: Shpërndarja e mostres së biznesit sipas industrisë, madhësisë së biznesit dhe rajonit administrative.....	35
Tabela 7: Shpërndarja e mostrës së biznesit sipas komunave.....	35
Tabela 8: Ndarja e komponentëve të kostos së parasë së gatshme.....	36
Tabela 9: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së debitit.....	36
Tabela 10: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së kreditit.....	37
Tabela 11: Ndarja e komponentëve të kostos së transferit të kreditit.....	37
Tabela 12: Ndarja e komponentëve të kostos së debitimit direkt.....	37
Tabela 13: Ndarja e komponentëve të kostos së parasë së gatshme.....	38
Tabela 14: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së debitit.....	38
Tabela 15: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së kreditit.....	39
Tabela 16: Ndarja e komponentëve të kostos së transferit të kreditit.....	39
Tabela 17: Ndarja e komponentëve të kostos së debitimit direkt.....	39
Figura 1: Qasja në llogari bankare sipas gjinisë dhe vendbanimit.....	11
Figura 2: Qasja në llogari bankare sipas grupmohës.....	12
Figura 3: Mbajtësit e kartelës së debitit dhe kreditit sipas gjinisë dhe vendbanimit (për të rriturit me qasje në një llogari bankare).....	12
Figura 4: Mbajtësit e kartelës së debitit dhe kreditit sipas grupmohës (për të rriturit me qasje në një llogari bankare).....	13
Figura 5: Shpërndarja e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumentit (%).....	15
Figura 6: Shpërndarja e pagesave vjetore të pranuar sipas rasti të përdorimit (%).....	16
Figura 7: Shpërndarja e pagesave vjetore të pranuar sipas llojit të kanalit të qasjes (%).....	16
Figura 8: Shpërndarja e pagesave vjetore të iniciuara sipas instrumentit (%).....	17
Figura 9: Shpërndarja e pagesave vjetore të iniciuara nga rasti i përdorimit (%).....	17
Figura 10: Shpërndarja e pagesave vjetore të iniciuara sipas llojit të kanalit të qasjes (%).....	18
Figura 11: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumentit për secilën industri biznesi.....	20
Figura 12: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumenteve për secilën madhësi të biznesit.....	20

Figura 13: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara nga industria për secilën industri të biznesit.....	22
Figura 14: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara nga instrumentet për secilën madhësi të biznesit.....	22
Figura 15: Kostot për transaksion sipas instrumentit të pagesës (në Euro).....	23
Figura 16: Koha (në minuta) për të hyrë në kanalin e qasjes, për të pritur në linjë dhe për të realizuar transaksionin.....	24
Figura 17: Kostot totale vjetore të konsumatorit sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2020.....	25
Figura 18: Kostot totale vjetore të biznesit sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2019.....	25
Figura 19: Kostoja vjetore e anës së ofertës sipas instrumentit të pagesës, si % e PBB-së së vitit 2019.....	26
Figura 20: Indikatorë kostoje të përzgjedhur nga ana e ofertës.....	27
Figura 21: Kostoja vjetore në ekonomi sipas instrumenteve të pagesës si % e PBB-së për vitin 2019.....	28
Figura 22: Gjinia (përqindja e të anketuarve).....	32
Figura 23: Vendbanimi (përqindja e të anketuarve).....	32
Figura 24: Niveli i arsimimit për të anketuarit.....	33
Figura 25: Të anketuarit sipas llojit të punësimit.....	33
Figura 26: Të anketuarit sipas grupmoshës.....	34
 Kutia Shpjeguese 1: Administrimi i anketimit të pjesëmarrësve të ndryshëm.....	10

FALËNDERIME

Përgatitja dhe publikimi i këtij raporti nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen bujare të Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) të Zvicrrës, përmes Programit të Remitancave dhe Pagesave (SECO Remittances and Payments Program – RPP) në Ballkan dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Autorët kryesor të këtij raporti janë **Holti Banka** (Banka Botërore) dhe **Siyi Wang** (Banka Botërore). **Oya Ardic** ishte udhëheqëse e ekipit të programit RPP nga Banka Botërore dhe **Maria Teresa Chimienti** dhe **Francesco Di Salvo** (të dy nga Banka Botërore), kanë ofruar komente të rëndësishëm gjatë shqyrtimit të raportit. **Edira Dashi** dhe **Gert Zenelaj** kanë ofruar respektivisht asistencë editoriale dhe pamore.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport bazohet në një studim të kostove të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë, i cili përdor metodologjinë e hartuar nga Grupi i Bankës Botërore për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave - PSDG (Udhëzimi Praktik për Matjen e Kostove të Pagesave me Vlerë të Vogël), si pjesë e praktikave Globale të Financave, Konkurrencës dhe novacionit. Studimi bazohet në të dhënat e anketave përmes pyetësorëve të administruar tek një mostër e përgatitur e ekonomive familjare dhe bizneseve, për pjesën e kërkesës, si dhe te 9 bankat komerciale të cilat operojnë në Kosovë, Banka Qendrore (si mbikëqyrës, rregullues dhe operues i sistemit të vetëm të pagesave në vend), operatorët për transferimin e parave dhe Postës për pjesën e ofertës.¹ Ky studim synon të krijojë një bazë të shëndoshë ekonomike për sistemin kombëtar të pagesave me vlerë të

vogël, në aspektin e kostove të instrumenteve të ndryshme të pagesave, në mënyrë që të drejtohet më mirë zhvillimi i sistemit dhe të mundësohen ndryshimet me një ndikim më të lartë. Rritja e efikasitetit që vjen nga zhvendosja drejt instrumenteve të pagesave të vogla me kosto më të ulët dhe një përdorim më efikas i këtyre instrumenteve, mund të ofrojë përfitime të konsiderueshme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike, përmes zvogëlimit të kostove të transaksioneve për shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Ulja e kostove të pagesave të vogla mund të përcjillet me zgjerimin e qasjes në pagesat elektronike te ekonomitë familjare me të ardhura më të ulëta, duke përmirësuar kështu efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave, përderisa zgjerohet qasja në instrumente më bashkëkohore të pagesave.

Gjetjet kryesore pas analizimit të të dhënave të mbledhura përmes anketimit të individëve/ekonomive familjare janë:

- Qasja në llogari bankare nga personat e moshës madhore në Kosovë është rreth 61 përqind, ku 47 përqind dhe 14 përqind e tyre posedojnë së paku një debit kartelë dhe një kreditë kartelë respektivisht.
- Ka një dallim gjinor (midis meshkujve dhe femrave) prej 15 përqind qasje më të lartë në llogari bankare të meshkujve, 13 përqind në posedim të debit kartelave dhe 9 përqind në posedim të kredit kartelave.
- Ka një ndarje ndërmjet zonave urbane me ato rurale në qasjen në llogari bankare: popullata urbane ka një qasje më të lartë të llogarive bankare dhe posedimit të debit dhe kredit kartelave me një përqindje prej 9, 11 dhe 7 pikë përqindje në raport me popullatën rurale.
- Nga të gjitha pagesat vjetore të iniciuara nga personat e moshës madhore, 97.7 përqind janë realizuar me para të gatshme dhe janë përqendruar në pikën e ndërveprimit² për blerjen e gjërave ushqimore dhe mallrave esenciale.³
- Sa i përket pagesave vjetore të pranuar, 71.8 përqind e tyre janë realizuar me para të gatshme. Instrumenti tjetër i pagesave që përdoret për të pranuar pagesa, siç raportohet nga të anketuarit është përmes transferit të kredisë.

¹ Anketimet për pjesën e kërkesës janë realizuar në periudhën janar-shkurt 2020, kurse për pjesën e ofertës në v.2018

² Pika ku paguesi dhe i paguari takohen (pikë e shitjes)

³ Këtu përfshihen mallrat ushqimore, buka dhe produkte të pjekura, gazi dhe transporti, gazetatat dhe revistat, si dhe alkooli dhe duhani.

- Kostot e përgjithshme vjetore të pagesës me vlerë të vogël me të cilat përballen individët arrijnë në 2.43 përqind të PBB-së të Kosovës për vitin 2019.
- Kostoja e parave të gatshme përbën 1.49 përqind të PBB-së, ndërsa instrumentet e pagesave elektronike (kolektivisht) zënë më pak se 0.65 përqind të PBB-së.
- Kanalet e shërbimeve të lidhura më ngushtë me përdorimin e parave të gatshme dhe instrumentet tjera të pagesave të bazuara në letër (p.sh. zyra e pagesës, agjent të pagesës, dega e bankës) janë më të kushtueshme për përdoruesit krahasuar me kanalet e tjera të shërbimit siç është interneti, si rezultat i kohës së kaluar për të mbërritur në vendin e shërbimit, siç është pritja në radhë dhe kryerja e transaksionit.

Gjetjet kryesore pas analizimit të të dhënave të mbledhura përmes anketimit të bizneseve janë si më poshtë:

- Sa i përket bizneseve, rreth 96.2 përqind kanë qasje në një llogari bankare, dhe prej tyre, 54.3 përqind kanë përdorur qasjen online në llogari gjatë tre muajve të fundit.
- Nga të gjitha vëllimet e pagesave të iniciuara nga bizneset, saktësisht gjysma e tyre janë me para të gatshme. Për sa i përket llojeve të biznesit, paraja e gatshme kontribuon në pjesën më të madhe të transaksioneve të iniciuara nga bizneset mikro dhe ato të vogla, përkatësisht 63 përqind dhe 43 përqind.
- Sa i përket pranimi të pagesave nga bizneset, 55 përqind e tyre realizohen me para në dorë, dhe pjesa e mbetur ndahet midis kartelave të debitit ose kreditit, transfereve të kreditit dhe debitimit direkt.
- Në total, bizneset në Kosovë pësojnë kosto vjetore të barabarte me 1.65 përqind të PBB-së (2019) në kontekstin e pranimi dhe inicimit të pagesave sipas të gjitha instrumenteve të pagesave, dhe vetëm përmes parave të gatshme me 1.03 përqind të PBB-së.
- Tre komponentët kryesorë më të rëndësishëm të koston së parave të gatshme kanë të bëjnë me rikonsilimin dhe tarifën për shërbimet e nënkontraktuara.⁴

Gjetjet kryesore pas analizimit të të dhënave të mbledhura përmes anketimit për anën e ofertes janë si më poshtë:

- Kostot e përgjithshme nga ana e ofertës të lidhura me të gjitha instrumentet e pagesës arrijnë në 0.37 përqind të PBB-së së Kosovës për vitin 2019.
- Kostot e parave të gatshme përbëjnë afërsisht gjysmën e të gjitha kostove të anës së ofertës. Në përputhje me rritjen e lëshimit të kartelave të debitit dhe transaksioneve me kartelë debiti, kostot e llogarisë së kartelave të debitit përbëjnë rreth 30 përqind të kostove të përgjithshme.
- Komponentët më të rëndësishëm të koston së parave të gatshme janë koha edhe logjistika.⁵ Për kartelat e debitit dhe të kreditit, tarifën e përpunimit të të dhënave dhe tarifën e shkëmbimit. Për debitimin direkt dhe transferet e kreditit, përbërësit më të mëdhenj të koston lidhen me depozitat/tërheqjet në sportel dhe procesin e arkivimit.

Gjetjet kryesore pas analizimit të të dhënave të mbledhura përmes anketimit për anën e kërkeses janë si më poshtë:

- Nga perspektiva e ekonomisë së agreguar, ekonomia kosovare mbart një kosto vjetore prej rreth 4.4 përqind të PBB-së për të gjithë instrumentet e pagesave me vlerë të vogël, akterët, kanalet e qasjes dhe rastet e përdorimit, ku vetëm kostot e parasë së gatshme përbën rreth 2.7 përqind të PBB-së, ose 60 përqind të të gjitha kostove.
- Kostoja e instrumentet e pagesave elektronike bashkërisht, arrin në rreth 1.4 përqind të PBB-së (ose 32 përqind të të gjitha kostove). Kursime të konsiderueshme mund të arrihen për banorët kosovarë në procesin e tranzicionit nga pagesa në letër në ato dixhitale, duke arritur deri në 1 përqind të PBB-së. Për raste specifike të përdorimit, për shembull, një zëvendësim prej 50 përqind të remitencave në para të gatshme me transfere elektronike do të gjeneronte kursime vjetore prej 30.7 milion €.

⁴ Në mënyrë specifike, kjo përfshinë kostot e menaxhimit dhe rikonsilimit të parasë së gatshme, zbrazja dhe balancimi i regjistrave të parave të gatshme / llogarive të parave të gatshme dhe zyrës mbështetese për manaxhim të parasë së gatshme; dhe pagesa e transportuesit profesional të parave për transportin e parave të gatshme.

⁵ Këtu përfshihen depozitat/hyrjet dhe tërheqjet/arkëtimet në bankë (në degët e bankave dhe agjentët) dhe trajtimin e parave të gatshme në zyrë, si dhe kostot e mirëmbajtjes dhe transportit të ATM-ve.



I. METODOLOGJIA

Forcimi i sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit kombëtar të pagesave dhe nxitja e përdorimit të instrumenteve efikase të pagesave janë qëllime të rëndësishme të politikës publike. Përdorim më i madh i pagesave elektronike sesa i parave të gatshme dhe instrumenteve të tjera të bazuar në letër, ka përfitime të rëndësishme ekonomike dhe sociale, duke përfshirë uljen e kostove dhe në këtë mënyrë rritjen e efikasitetit ekonomik dhe zgjerimin e qasjes në shërbimet financiare për ata që përjashtohen aktualisht.

Metodologjia e aplikuar në këtë studim për Kosovën bazohet në Udhëzimin Praktik për Matjen e Kostove të Pagesave me Vlerë të Vogël.⁶ Studimi synon të shqyrtojë transaksionet e pagesave në kontekstin e përgjithshëm të përdorimit të tyre duke përfshirë faktor të rëndësishëm që mund të ndikojnë në kostot e pagesave me vlerë të vogël, si p.sh.: lloji i pagesës, mënyra e realizimit dhe rasti i përdorimit. Dy kategoritë kryesore të mënyres së realizimit/kanaleve të qasjes janë pagesa me prezencë fizike (për shembull, pika e ndërveprimit, ATM, dega e bankës, zyra e pagesës, agjenti) dhe pagesa në distancë (interneti, rrjeti i telefonit/telefonit celular). Raste të ndryshme përdorimi konsiderohen gjithashtu në kontekstin e konsumatorëve (p.sh. remitancat, pagesa për mallra/shërbime, pagesa për fatura periodike, paga, pensione, e kështu me radhë). Ndersa, për sa i përket instrumenteve të pagesës, janë si më poshtë: para të gatshme, kartelë debiti, kartelë krediti, transfer kredie dhe debitim direkt (i bazuar në letër dhe elektronik për këto të fundit).

Në mënyrë specifike, nga ana e kërkesës së akterëve të pagesave me vlerë të vogël, analiza e konsumatorit vë në pah kursimet e mundshme që mund të lindin nga kalimi i pagesave bazuar në letër në pagesat në mënyrë elektronike. Kursimet në secilin skenar paraqiten duke përdorur shifrat vjetore të kostos dhe duke marrë parasysh parashikime të reduktimit që rezultojnë nga kalimi nga një instrument pagese (p.sh. transferi i kredisë me bazë letre) në një tjetër (p.sh. transferi elektronik i kredisë) për raste të ndryshme të përdorimit si pagesa me vlerë të vogël, remitancat, pagesat e pagave dhe pensione.

Për anën e ofertës, depozitat dhe tërheqjet (nga llogaria personale dhe llogaritë e palëve të treta) gjithashtu shqyrtohen, ndaras nga pagesat / transferet aktuale, si nga instrumenti i pagesës i përdorur (p.sh. kartela e debiti, kartela e kreditit), si dhe kanali i qasjes (p.sh. dega e bankës, ATM). Pavarësisht nga instrumenti i ndërmjetëm i përdorur gjatë tërheqjes, të gjitha kostot e tërheqjes janë të lidhura me para të gatshme në këtë analizë.

Anketimet e konsumatorëve dhe biznesit (nga ana e kërkesës) janë kryer në janar/shkurt të vitit 2020 ndërsa anketimet e shërbimeve të pagesave dhe ofruesve të infrastrukturës (nga ana e ofertës) janë kryer në pranverën e vitit 2018. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim i madh në tregun e pagesave me vlerë të vogël në Kosovë nga ana e kërkesës gjatë këtyre dy viteve, supozohet se vëllimet dhe kostot e raportuara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe infrastrukturës janë gjithashtu të vlefshme për vitin 2019 (para COVID-19). Si i tillë, viti 2019 përdoret si një vit referimi për analizën në të gjithë anën e kërkesës dhe ofertës.⁷

⁶ Për një lexim më të thellë të kuadrit të përgjithshëm metodologjik, ju lutem shikoni:

<http://documents1.worldbank.org/curated/en/255851482286959215/pdf/111216-WP-P155382-PUBLIC-ABSTRACT-SENT.pdf>

⁷ E gjithë mbledhja e të dhënave për këtë analizë u realizua para-COVID dhe për këtë arsye, nuk ka implikime në lidhje me të dhënat që trajtohen për të përfaqësuar një periudhë të jashtëzakonshme kohore. Për më tepër, hendeku kohor midis mbledhjes së të dhënave nga kërkesa dhe oferta është vërejtur edhe në analiza të tjera të ngjashme, por nuk ka ndonjë implikim për analiza ose konkluzione.

Konsumatorët: Sa i përket mbledhjes së të dhënave, kompania anketuese (UBO Consulting) administroi anketimin përmes intervistave ballë për ballë dhe duke përdorur kompjuterin gjatë anketimit, ndërmjet 18 shkurtit dhe 18 marsit 2020, në 38 komuna në të gjithë Kosovën. Mostra u zgjedh duke përdorur një proces të stratifikuar në disa faza të identifikimit dhe përzgjedhjes duke siguruar variancë minimale dhe kosto për të gjitha vlerësimet, duke ruajtur gjithashtu aftësinë për të marrë vlerësime të vlefshme të pikave dhe variancave për parametrat e popullsisë me interes. Koeficienti u zbatua për të pasqyruar strukturën e popullsisë, për sa i përket përkatësisë etnike dhe grupmoshës. Analiza përfshiu gjithsej 1,001 të anketuar me një mostër përfaqësuese të të rriturve të zgjedhur rastësisht (mosha 18 e lartë) të gjinive dhe etnive të ndryshme dhe nëpër zonat e vendbanimeve (d.m.th. urbane dhe rurale).

Bizneset: Firma UBO Consulting administroi anketimin e biznesit përmes hulumtimeve në terren midis 20 janarit dhe 28 shkurtit 2020, duke mbuluar bizneset nga zonat urbane dhe rurale në 7 rrethet administrative të Kosovës. Lista e bizneseve të regjistruara të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), u përdor si bazë për kornizën e mostrave të studimit të biznesit. Për të zgjedhur mostrën u përdor një teknikë e mostrimit të stratifikuar, me një madhësi përfundimtare të mostrës prej 395 biznese. Shtresat e kësaj mostre u bazuan në pesë sektorë ekonomikë (ndërtim, prodhim, shërbime, tregti dhe transport) dhe katër kategori të madhësive të biznesit (mikro-biznese, biznes i vogël, i mesëm dhe i madh). Duke marrë parasysh rëndësinë e Prishtinës, kryeqytetit, si qendra kryesore ekonomike e vendit, rreth 30 përqind e kompanive në mostër ishin të vendosura në kryeqytet. Nga 395 biznese të zgjedhura për tu intervistuar, 192 përfunduan intervistën, 139 refuzuan të marrin pjesë, ndërsa 64 biznese ishin mbyllur, nuk u gjeten ose nuk mund të krijoheshin asnjë kontakt. Bizneset që u përgjigjen vinin nga të pesë sektorët ekonomikë; sektori më i madh ishte tregtia. Për sa i përket gjeografisë, bizneset që u përgjigjen u shpërndanë nëpër zonat rurale dhe urbane, duke mbuluar 27 komuna të të gjitha 7 rrethëve administrative të Kosovës. Numri i kufizuar i bizneseve të intervistuar gjithashtu kufizoi shkallën e saktësisë së detajeve në analizë dhe të dhënave të biznesit, përfshirë efektin e koston në instrumente të ndryshme pagese dhe rastet e përdorimit në bazë të një transaksioni.

Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave (PSP)/ Ofruesit e Infrastrukturës së Pagesave (PIP): Për anën e ofertes së tregut të pagesave në Kosovë, nuk është përdorur asnjë teknikë e marrjes së mostrave duke pasur parasysh numrin e vogël të aktereve të anës së ofertës në treg. Të dhënat u mblodhën nga: 9 banka komerciale (nga 11 që operojnë në Kosovë); Banka Qendrore e Kosovës (në rolin Ofruesit të Shërbimit të Pagesave PSP dhe si Ofrues i Infrastrukturës së Pagesave si operator i sistemit ACH); 4 operatorë të transferimit të parave (MTO); zyra postare. Pyetësorët e personalizuar u dërguan në mënyrë elektronike tek secili institucion pjesëmarrës. Të anketuarve u është dhënë koha prej dy muajsh për të mbushur pyetësorët (duke pasur parasysh që të dhënat nga departamente të ndryshme duhej të mblidheshin së bashku) dhe të dërgohen më pas në BQK dhe Bankën Botërore. Çështjet / pyetjet që dolën gjatë këtij afati kohor u adresuan nga ekspertët e BQK-së dhe Bankës Botërore. Pasi kontrolli i cilësisë së të dhënave, ku në disa raste u kërkuan informacione dhe sqarime shtesë nga institucionet që përgjigjeshin, veçanërisht kur kishte ndonjë mospërputhje apo gabime. Duhet theksuar që të dhënat analizohen dhe prezantohen sipas instrumentit të pagesës, duke grumbulluar të gjitha llojet e ndryshme të institucioneve, në mënyrë që të ruhet anonimiteti dhe konfidencialiteti.




II. QASJA NË PAGESAT ELEKTRONIKE

II.1 KONSUMATORËT

Sipas gjetjeve të anketimit, 60.9 përqind e të rriturve Kosovarë kanë qasje në një llogari bankare⁸. Hendeku gjinor në pronësinë e llogarisë është 15.2 pikë përqindje, me 53.2 përqind femra përkundrejt 68.4 përqind meshkuj që kanë qasje në një llogari bankare. Për më tepër, pronësia e llogarisë bankare bie në 56.6 përqind të popullsisë së moshës madhore në zonat rurale, krahasuar me 65.5 përqind në zonat urbane.


Figura 1: Qasje në llogari bankare sipas gjinisë dhe vendbanimit



Në të gjithë kategoritë e moshave, të rriturit e moshës mbi 65 vjeç paraqesin përqindjen më të lartë për qasjen në llogari bankare me 74 përqind, të ndjekur nga ata të grupmoshës 25 deri 34 (69 përqind) dhe 55 deri 64 vjeç (64 përqind). Gjetjet për grupin e të moshuarve (65+) mund të shpjegohen me faktin se të gjithë të moshuarit në pension marrin pensionet e tyre direkt në llogaritë bankare dhe si të tillë, si parazgjedhje duhet të kenë qasje në një llogari bankare.


⁸ Llogaria e mbajtur në bankat komerciale të cilat i mundësojnë përdoruesit të mbaj depozita dhe të iniciojë / pranojë pagesa.

Figura 2: Qasja në llogari bankare sipas grupmoshës




Për më tepër, 47.6 përqind e atyre që u përgjigjën se kishin qasje në një llogari bankare raportuan se kishin një kartelë debiti ndërsa 14.4 përqind raportuan se kishin një kartelë krediti. Hendeku gjinor në pronësinë e kartelës së debitit është 13.6 pikë përqindje (40.7 përqind te femrat përkundrejt 54.2 përqind te meshkujt). Të rriturit që jetojnë në zonat urbane kanë 11.6 pikë përqindje më shumë të ngjarë të kenë një kartelë debiti sesa ata që jetojnë në zonat rurale (53.5 përqind kundrejt 41.9 përqind). Hendeku gjinor në pronësinë e kartelës së kreditit është më i vogël në 9.2 pikë përqindje. Intervistuesit në zonat rurale kanë rreth 7.5 pikë përqindje më pak të ngjarë të zotërojnë një kartelë krediti krahasuar me ata nga zona urbane (11.4 përqind kundrejt 17.9 përqind).

Figura 3: Mbajtësit e kartelës së debitit dhe kreditit sipas gjinisë dhe vendbanimit (për të rriturit me qasje në një llogari bankare)



Në të gjithë kategoritë e moshave, për të rriturit me qasje në një llogari bankare, përqindja më e lartë e mbajtësve të kartelave të debitit u vu re për moshat 25 deri në 34 vjeç (58.4 përqind).

Figure 4: Mbajtesit e kartelës së debitit dhe kreditit sipas grupmoshës (për të rriturit me qasje në një llogari bankare)



Kosovarët të punësuar zyrtarisht në sektorin publik kanë më shumë mundësi për qasje në një llogari bankare me 88.0 përqind të ndjekur nga ata që janë të vetëpunësuar me 77.8 përqind. Të rriturit që ishin të papunë ose studionin kishin shumë më pak të ngjarë të zotëronin një llogari bankare përkatësisht me 34.5 për qind dhe 50.6 për qind. Pronësia e kartelës së debitit është gjithashtu më e lartë midis atyre të punësuarve në sektorin zyrtar me 69.0 përqind, midis punonjësve të sektorit publik dhe 67.0 përqind për ata që janë të punësuar në sektorin jo-publik. Të anketuarit e vetëpunësuar me përkatësisht 58.0 përqind. Pronësia e kartelës së kreditit është më e larta midis atyre të punësuarve në sektorin publik me 48.0 përqind, e ndjekur nga ata që janë të vetëpunësuar dhe atyre të punësuar në sektorin jopublik (përkatësisht 32.0 dhe 30.0 përqind).

Nivelet e arsimit gjithashtu duket se luajnë një rol në pronësinë e llogarisë bankare, për ata që kanë përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar të cilët kanë më shumë gjasa të kenë qasje në një llogari bankare përkatësisht me 92.1 përqind dhe 80.3 përqind. Ata me arsim të mesëm ose aftësim profesional kanë më pak të ngjarë të zotërojnë një llogari bankare përkatësisht në 57.0 dhe 58.0 përqind. Pronësia e kartelave të kreditit gjithashtu rritet me nivelet e arsimit të lartë - të rriturit me një universitet (36.0 përqind) ose post-universitar (51.0 përqind) kanë shumë më shumë gjasa të kenë një kartelë krediti krahasuar me ata me vetëm një nivel arsimit fillor (11.0 përqind) ose të mesëm (20.0 përqind).⁹

II.2 BIZNESET

Sipas gjetjeve të studimit, një shumicë dërrmuese e bizneseve të anketuara në Kosovë (96.2 përqind) kanë qasje në një llogari bankare. Hendeku i qasjes në llogari, bazuar në madhësinë e biznesit, nuk është domethënës. Bizneset e vogla, të mesme dhe ato të mëdha duket se kanë qasje të njëjtë në një llogari bankare, ndërsa vetëm 5.5 përqind e bizneseve mikro raportojnë se nuk kanë qasje në një llogari bankare. Sidoqoftë, pronësia ndryshon bazuar në llojin e industrisë. Të gjitha bizneset në sektorin e ndërtimit dhe prodhimit kanë qasje në një llogari bankare, krahasuar me 96.3 përqind dhe 91.1 përqind të atyre në tregti dhe industrin e shërbimeve respektivisht.

⁹ Të dhënat për të ardhurat nuk u pyetën në anketat individuale duke pasur parasysh ndjeshmërinë e informacionit. Sidoqoftë, një informacion i tillë nuk është kritik për analizën thelbësore të këtij studimi.

Tabela 1: Qasja në llogari bankare, shpërndarja (%) e përgjithshme dhe sipas madhësisë së industrisë dhe biznesit

		Qasja në llogari (%)
Të gjitha bizneset		96.0%
Sipas sektorit	<i>Ndërtim & Prodhimtari</i>	100.0%
	<i>Shërbime</i>	91.1%
	<i>Tregti</i>	96.3%
Sipas madhësisë së firmës	<i>Bisnese MiKro</i>	94.5%
	<i>Biznese të Vogla</i>	100.0%
	<i>Biznese të Mesme</i>	100.0%
	<i>Biznese të Mëdha</i>	100.0%

Për sa i përket përdorimit të 'online banking', në përgjithësi, pothuajse gjysma (54.3 përqind) e atyre që posedojnë një llogari kanë qasje në internet, që është pjesëmarrje e dukshme pavarësisht nga fakti se nivelet e qasjes në llogari janë të krahasueshme mes industrive.¹⁰ Kur segmentohen sipas llojit të industrisë, afërsisht gjysma e bizneseve në sektorët e shërbimeve dhe tregtisë përdorin bankingun online, dhe ky numër rritet në 57.6 përqind për bizneset në industrinë e ndërtimit dhe të prodhimit. Vlen të përmendet se përdorimi i bankingut online ndryshon nga madhësia e biznesit. Sipas analizës së mostrës, të gjitha bizneset e mëdha në Kosovë përdorin banking online, krahasuar me afërsisht 90.9 përqind, 73.7 përqind dhe 39.1 përqind respektivisht për bizneset e mesme, të vogla dhe mikro.

Tabela 2: Qasjes online në llogari, shpërndarja (%) e përgjithshme dhe sipas madhësisë së industrisë dhe biznesit

		Qasja në llogari (%)
Të gjitha bizneset		54.3%
Sipas sektorit	<i>Ndërtim & Prodhimtari</i>	57.6%
	<i>Shërbime</i>	53.3%
	<i>Tregti</i>	52.4%
Sipas madhësisë së firmës	<i>Bisnese Mikro</i>	39.1%
	<i>Biznese të Vogla</i>	73.7%
	<i>Biznese të Mesme</i>	90.9%
	<i>Biznese të Mëdha</i>	100.0%

¹⁰ Përdorimi i bankingut online "Online banking" përfshin rastet kur biznesi ka përdorur shërbimet bankare përmes bankingut online së paku një herë gjatë tre muajve të fundit..



III. RRJEDHA E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL


III.1. KOSUMATORËT

Kostot janë një funksion i vëllimit të transaksioneve, midis variablave të tjerë, prandaj seksioni i konsumatorëve analizohet sipas vëllimit të pagesave (si të pranuar ashtu edhe të iniciuara) ndërmjet instrumenteve të ndryshme të pagesave, rasteve të përdorimit dhe kanaleve të qasjes të përdorura. Konsumatorët/individët në Kosovë iniciojnë dhe pranojnë gjithsej rreth 233.8 milion pagesa në vit (nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm pagese, raste përdorimi dhe kanale qasjes) ose 176.9 pagesa/për të rritur në vit, nga të cilat 87.4 përqind ishin me para të gatshme.¹¹

III.1.1 Pagesat e pranuar

Rreth 23.4 milion pagesa pranohen nga konsumatorët çdo vit në Kosovë, ose 17.7 pagesa/për të rritur, nga të cilat 72.0 përqind e pagesave pranohen përmes parave të gatshme, ndërsa pjesa tjetër prej 28.0 përqind pranohen përmes transfereve elektronike të kredisë.


Figura 5: Shpërndarja e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumentit (%)



Për sa i përket shpërndarjes së rasteve të përdorimit, shumica e pagesave pranohen në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të ofruara për konsumatorët individualë dhe zënë 34.6 përqind. Pagesat e pagave pasojnë me 30.2 përqind, ndërsa remitancat dhe transferimet e pensioneve zënë përkatësisht 18.9 dhe 12.3 përqind, dhe përfitimet e ndihmës sociale në 3.8 përqind.

¹¹ Informacioni i popullsisë nga baza e të dhënave e Bankës Botërore: <https://data.worldbank.org/indicator/SP.POP.GROW?locations=XK>


Figura 6: Shpërndarja e pagesave vjetore të pranuar sipas rastit të përdorimit (%)



Nga pagesat e pranuar për mallra dhe shërbime, 93.0 përqind realizohen me para të gatshme. Paraja e gatshme është gjithashtu instrumenti kryesor që përdoret për remitancat (72.0 përqind). Pagesat e pensioneve, nga ana tjetër, realizohen përmes transfereve të kredisë.

Kur analizohet rrjedha e pagesave të pranuar nga lloji i kanalit të qasjes, një pjesë e konsiderueshme merret në pikën e ndërveprimit - midis individëve (51.3 përqind), e ndjekur nga llogaritë bankare në 37.4 përqind. Pagesat e mbetura pranohen përmes zyrave të agjentëve (4.8 përqind) dhe zyrave qeveritare (1.2 përqind).


Figura 7: Pagesat vjetore të marra sipas kanalit të qasjes (%)



III.1.2. Pagesat e iniciuara


Në bazë vjetore, rreth 210.4 milion pagesa janë iniciuar nga të rriturit në Kosovë, ose 159.2 pagesa / të rritur, nga të cilat 97.7 përqind përmes parave të gatshme. Transaksionet me kartelë debiti ndjekin 1.7 përqind të totalit të pagesave të iniciuara dhe transaksionet me kartela të kreditit 0.4 përqind. Transfertat e kredisë dhe pagesat e debitimit direkt llogariten në proporcione të papërfillshme të transaksioneve të përgjithshme, përkatësisht me 0,05 dhe 0,04 përqind.

Figura 8: Pagesat vjetore të iniciuara sipas instrumentit (%)



Kur të dhënat analizohen sipas rastit të përdorimit, shumica e pagesave bëhen për blerjen e mallrave thelbësore¹² me 78.1 përqind, e ndjekur nga shërbimet¹³ me 20.3 përqind. Pagesat e iniciuara ndaj mallrave të qëndrueshme¹⁴, transferimet e fondeve¹⁵ dhe pagesat e qeverisë¹⁶ janë në një vëllim më të ulët përkatësisht 1.0, 0.2 dhe 0.1 përqind.

Figura 9: Shpërndarja e pagesave vjetore të iniciuara sipas qëllimit (%)



¹² Mallrat thelbësore: Kjo përfshin ushqime dhe furnizime ushqimore, bukë dhe produkte të pjekura, gaz dhe transport, gazeta dhe revista, dhe alkool dhe duhan.

¹³ Shërbimet: Kjo përfshin pagesa ndaj produkteve farmaceutike, restoranteve, parukerive, shërbimeve shtëpiake (hidraulikë, elektrikistë etj.), shërbime shtëpiake, vizita shëndetësore dhe dentare, argëtim, udhëtime në distanca të largëta, mirëmbajtje automjetesh, shërbime (ujë, energji elektrike, telefon, tarifat shkollore, tarifat dhe hipotekat), dhe sigurimet (sigurime shëndetësore dhe të tjera).

¹⁴ Mallra të qëndrueshme: Kjo përfshin mallra si roba, këpucë, pajisje shkollore, pajisje elektronike, mobilje, bagëti dhe pajisje (bujqësore dhe jo-bujqësore).

¹⁵ Transferimi i fondeve / remitancat: Kjo përfshin transferimin e fondeve midis miqve dhe të afërmeve (brenda dhe jashtë vendit) pa shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve.


¹⁶ Pagesat e qeverisë: Kjo mund të përfshijë, ndër të tjera, shlyerjen e taksave dhe kredive për pagesa të iniciuara nga konsumatorët; dhe ndihma e mirëqenies sociale, ndihma financiare dhe subvencionet qeveritare për pagesat e marra nga konsumatorët.

Për më tepër, shumica e pagesave të bëra për mallra dhe shërbime thelbësore iniciohen me para të gatshme me 98.0 përqind secila. Tetëdhjetë e shtatë përqind e remitancave ose transferimi i fondeve midis miqve dhe të afërme bëhen në para të gatshme ndërsa 13.0 përqind përmes transferimeve të kredive. 2.0 përqind e pagesave ndaj mallrave të qëndrueshme bëhen përmes kartelave të kreditit. Kartelat e debitit dhe kartelat e kreditit llogaritin pagesat e mbetura të iniciuara në raste të ndryshme përdorimi.

Për sa i përket shpërndarjes nëpër kanalet e qasjes, pagesat e iniciuara në pikën e ndërveprimit zënë 94 përqind, dhe ato përmes internetit 3,0 përqind. 3.0 përqindja e mbetur e pagesave/transferimeve iniciohet në pikat e agjentëve (1.0 përqind), degët e bankave (1.0 përqind) ose zyrat e pagesave të qeverisë (1.0 përqind).

Ndër të gjitha pagesat e internetit, 79.7 përqind iniciohen përmes kartelës së debitit, 16.7 përqind përmes kartelës së kreditit, 2.0 përqind përmes transferit të kredisë dhe 1 përqind përmes debitimit direkt.

Figura 10: Shpërndarja e pagesave vjetore të iniciuara sipas kanalit (%)



III.2. BIZNESET

Mesatarisht, bizneset në Kosovë iniciojnë dhe pranojnë çdo vit gjithsej rreth 131.8 milion pagesa/ transfera (nëpër instrumenteve të ndryshëm pagese, raste përdorimi dhe kanale qasje), nga të cilat 52.9 përqind në para të gatshme.

III.2.1 Pagesat e pranuar

Bizneset e Kosovës pranojnë afërsisht 88.8 milion pagesa në vit, mbi gjysma¹⁷ (55.0 përqind) e të cilave realizohen me para të gatshme, 18.6 përqind përmes transferit të kredisë, 12.6 përqind me kartela debiti, 8.4 përqind përmes debitimit direkt dhe 5.4 përqind me kartela krediti.


Kur ndahen sipas industrisë, bizneset në industrinë e tregtisë marrin vëllimin më të madh të pagesave krahasuar me ndërtimet dhe industritë e prodhimit dhe të shërbimeve, duke zënë 56.0 përqind të transaksioneve totale. Dhe nga madhësia e biznesit, bizneset e mëdha dhe mikro bizneset së bashku kontribuojnë në shumicën dërrmuese (afërsisht 99.0 përqind) të pagesave të pranuar.

Tabela 3: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar nga industria, madhësia e biznesit dhe instrumenteve të pagesave

		Qasja në llogari (%)
Sipas sektorit	<i>Ndërtim & Prodhimtari</i>	20.0%
	<i>Shërbime</i>	24.0%
	<i>Tregti</i>	56.0%
	Gjithsej	100.0%
Sipas madhësisë së firmës	<i>Biznese Mikro</i>	31.2%
	<i>Biznese të Vogla</i>	0.2%
	<i>Biznese të Mesme</i>	0.7%
	<i>Biznese të Mëdha</i>	67.9%
	Gjithsej	100.0%
Sipas instrumentit të pagesës	<i>Para të Gatshme</i>	55.0%
	<i>Kartelë Debiti</i>	12.6%
	<i>Kartelë Krediti</i>	5.4%
	<i>Transfer Krediti</i>	18.6%
	<i>Debitim Direkt</i>	8.4%
Gjithsej	100%	


Ky numër vlerësohet në 46.3 përqind dhe 37.9 përqind për bizneset në ndërtim dhe në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve respektivisht.

Figura 11: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumentit për secilën industri biznesi



Për më tepër, paraja e gatshme kontribuon në pjesën më të madhe të transaksioneve të pranuar nga bizneset, pavarësisht nga madhësia e tyre. Në mikro bizneset, 61.5 përqind e transaksioneve të pranuar realizohen me para të gatshme, ndërsa kjo përqindje bie në 35.8 përqind për bizneset e mëdha.

Figura 12: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të pranuar sipas instrumenteve për secilën madhësi të biznesit



III.2.2. Pagesat e iniciuara

Nga ana e inicimit, afërsisht 43 milion pagesa janë iniciuar nga bizneset e Kosovës në vit, nga të cilat gjysma janë në para të gatshme, 32.0 përqind përmes transferit të kredisë, 11.0 përqind përmes debitimit direkt, 5.0 përqind me kartela debiti dhe 2.0 përqind me kartela krediti.

Kur ndahen pagesat e iniciuara sipas industrisë, shihet se bizneset në industrinë e shërbimeve realizojnë pjesën më të madhe të pagesave, duke zënë 61.0 përqind të transaksioneve gjithsej. Dhe kur ndahen sipas madhësisë së biznesit, shumica e pagesave inicohen nga mikro bizneset (67.0 përqind).


Tabela 4: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara sipas industrisë, madhësisë të biznesit dhe instrumenteve të pagesës

	Qasja në llogari (%)	
Sipas sektorit	<i>Ndërtim & Prodhimtari</i>	7.0%
	<i>Shërbime</i>	60.0%
	<i>Tregti</i>	33.0%
	Gjithsej	100.0%
Sipas madhësisë së firmës	<i>Biznese Mikro</i>	67.0%
	<i>Biznese të Vogla</i>	1.0%
	<i>Biznese të Mesme</i>	11.0%
	<i>Biznese të Mëdha</i>	21.0%
	Gjithsej	100.0%
Sipas instrumentit të pagesës	<i>Para të Gatshme</i>	50.0%
	<i>Kartelë Debiti</i>	5.0%
	<i>Kartelë Krediti</i>	2.0%
	<i>Transfer Krediti</i>	32.0%
	<i>Debitim Direkt</i>	11.0%
	Gjithsej	100.0%

Siç tregon studimi, pjesa më e madhe e pagesave të iniciuara nga bizneset përfaqësohet nga paraja e gatshme, pavarësisht industrisë së tyre, me transferet elektronike të kredisë në vendin e dytë. Bazuar në analizën e përgjigjeve, mbi gjysma e transaksioneve të iniciuara realizohen me para të gatshme për bizneset në ndërtim & industrinë e prodhimit dhe tregtisë, krahasuar me afërsisht 42.0 përqind për ato në industrinë e shërbimeve. Për më tepër, rreth 30.0 përqind e pagesave inicohen përmes transfereve elektronike të kredisë nga bizneset në të tre llojet e industrive.


¹⁷ Kjo shifër mund të ndikohet nga numri i vogël i bizneseve mikro dhe të vogla të anketuara, duke qenë se më shumë se 50% e kampionit nuk mund të intervistoheshin (nuk u gjetën/nuk u përgjigjën).

Figura 13: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara sipas instrumentit dhe industrisë së biznesit



Përdorimi i instrumenteve ndryshon nga lloje të ndryshme të biznesit. Është vlerësuar se paraja e gatshme kontribuon në pjesën më të madhe të transaksioneve të iniciuara nga mikro dhe bizneset e vogla, me 63.1 përqind dhe 43.3 përqind respektivisht. Ndërsa për bizneset e mesme dhe të mëdha, transfereri elektronik i kredisë është instrumenti më i përdorur i pagesave, duke kontribuar përkatësisht në 40.3 përqind dhe 65.6 përqind të transaksioneve të tyre.

Figura 14: Shpërndarja në përqindje e pagesave vjetore të iniciuara sipas instrumentit dhe madhësisë së biznesit





IV. KOSTOT E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL

IV.1. KONSUMATORËT


Kostot janë një funksion i vëllimit të transaksioneve, midis variablave të tjerë. Prandaj, seksioni i konsumatorit analizohet nga vëllimi i pagesave (si të pranuar ashtu edhe të iniciuara) përmes instrumenteve të ndryshme të pagesave, rasteve të përdorimit dhe kanaleve të aksesit.

Kostot për transaksion për të gjitha instrumentet e pagesave përfshijnë:

- tarifa për të iniciuar një pagesë (kur është e përshtatshme) - si personalisht ashtu edhe nga distanca;
- tarifatat e lidhura me një kanal të caktuar të qasjes dhe;
- kostot e bazuara në kohë (të konvertuara në terma monetarë) të shkaktuara si rezultat i kohës së investuar për të arritur në kanalin e qasjes, duke pritur në radhë dhe duke realizuar transaksionin.

Kostot më të larta për transaksion shoqërohen me transferet e kreditit të bazuara në letër dhe debitimet direkte të bazuara në letër, në €2,49 dhe €2,30 respektivisht. Vazhdon paraja e gatshme me një kosto për transaksion prej €0,45. Në të kundërt, transferet elektronike të kreditit dhe debitimi direkt kanë të njëjtën kosto dhe koston më të ulët për transaksion, ekuivalente me €0,11.

Figura 15: Kostot për transaksion sipas instrumentit të pagesës (në Euro)




Kostot fikse të shoqëruara me instrumente të ndryshëm pagese përfshijnë tarifa vjetore për mirëmbajtjen e një llogarie bankare dhe vetë instrumentin e pagesës, dhe kostot e bëra nga koha e investuar në shqyrtimin e pasqyrave bankare dhe kartelave të kreditit.

Siç kuptohet nga analiza, konsumatorët Kosovarë përballen me kostot më të larta totale kur udhëtojnë, duke pritur në radhë dhe duke ndërmarrë një transaksion në një zyrë qeveritare të pagesave në 32 minuta¹⁸, pasuar nga një degë bankare në 29 minuta. Zyrat e agjentëve

¹⁸ Zyrat e pagesave qeveritare demonstrojnë koston më të lartë të lidhur me procedurën e mbledhjes së parave të gatshme. Zyrat e agjentëve janë gjithashtu të punësuar kryesisht për qëllime të pagesës së parave të gatshme. Degët e bankave përdorin kryesisht për transfertat e kredisë dhe debitë direkte.

dhe Bankomati (ATM) ndjekin përkatësisht në 24 dhe 22 minuta. Vlen të përmendet se këto mesatare nxiten gjithashtu nga distancat e gjata që u duhen individëve për të udhëtuar në zonat rurale dhe gjysmë rurale për të arritur në një kanal fizik të qasjes. Kosova ka numrin e dytë më të ulët të ATM për 1 milion banorë (pas Shqipërisë) në Ballkan, me 279, me Maqedoninë e Veriut që ka më të lartën me 500.¹⁹

Figura 16: Koha (në minuta) për të aksesuar kanal, pritje në radhë dhe për të kryer transaksionin.



Bazuar në kohën e kaluar për të arritur në kanalet e ndryshme të qasjes, kohën e kaluar në pritje në radhë dhe kohën e marrë për të realizuar transaksionin, kostoja mesatare për transaksion përmes çdo kanali të qasjes llogaritet duke përdorur pagën minimale si përfaqësues.²⁰

Duke kombinuar instrumentet e pagesave me kanalet e qasjes, analiza tregon se instrumentet e pagesave të bazuara në letër (p.sh. transferet e kreditit në letër, debitimet direkte të bazuara në letër dhe paratë e gatshme), janë më të kushtueshme sesa instrumentet e pagesave elektronike (1.8 përqind e PBB-së kundrejt 0.6 përqindja e PBB-së). Për pagesat e iniciuara, kombinimi më i kushtueshëm duket të jetë pagesa me para të gatshme në zyrat e pagesave të institucioneve publike, ndërsa më pak të kushtueshme janë transferet elektronike të kreditit dhe debitimi direkt, ose pagesa të kartelave të debitit / kreditit të bëra përmes internetit.

Në përgjithësi, konsumatorët Kosovarë bartin kosto ekonomike vjetore prej 2.43 përqind të PBB-së²¹ të vendit në të gjithë instrumentet e pagesave, kanalet e qasjes dhe rastet e përdorimit, duke marrë parasysh kostot variable dhe fikse. Vetëm paraja e gatshme përbën 1.49 përqind të PBB-së vjetore.²² Kartelat e debitit dhe transferet e kreditit të bazuara në letër pasojnë me 0.39 dhe 0.26 përqind të PBB-së së vendit. Vlen të theksohet se disa nga këto kosto të përgjithshme rrjedhin nga një kosto e lartë për transaksion ndërsa të tjerët nga një vëllim i lartë (p.sh. kartelat e debitit), por për para të gatshme të dyja qëndrojnë reale. Nuk është për t'u habitur që shumica dërrmuese e kostove që lidhen me përdorimin e instrumenteve të bazuara në letër janë kosto oportune të bazuara në kohë, për shkak të faktit se ato kërkojnë praninë fizike dhe udhëtimet e paguesit/ të paguarit në pothuajse të gjitha rastet. Në mënyrë të ngjashme, pritjet që shumica e kostove për instrumentet e pagesave elektronike të jenë kosto monetare direkte që burojnë nga tarifa të ndryshme të ngarkuara.

¹⁹ Raporti Vjetor mbi Instrumentet e Pagesave. BQK, 2020.


<https://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Annual%20comparative%20report%20on%20electronic%20instruments.pdf>

²⁰ Paga minimale mesatare mujore u mor si 150 € (<https://www.tiranatimes.com/?p=144135>), dhe duke supozuar 40 orë punë jave, kostoja monetare e një minute ishte llogaritur të ishte 0,02 €

²¹ PBB, Kosovë 2019.

²² PBB i Kosovës për vitin 2019 është llogaritur të jetë: 6.9 billion.

Figura 17: Kostot totale vjetore të konsumatorit sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2020




IV.2. BIZNESET

Kur grumbullohen kostot (sipas instrumentit të pagesës) pavarësisht nga madhësia e biznesit, instrumenti më i kushtueshëm i pagesës është paraja e gatshme. Kostoja vjetore e parave të gatshme për të gjitha bizneset në Kosovë arrin afërsisht 72.5 milion €, e ndjekur nga kostoja e kartelave të debitit në 16.6 milion €, transferert e kreditit në 13.9 milion €, debitimet direkte elektronike në 7 milion €, dhe kartelat e kreditit në 6.3 € milion. Për sa i përket peshës së secilit instrument në raport me kostot totale, paraja e gatshme arrin 62.3 përqind, kartela e debitit 14.3 përqind, transfereret elektronike të kredisë me 11.9 përqind, debitimet direkte elektronike me 6 përqind dhe kartela e kreditit me 5.4 përqind.

Në përgjithësi, bizneset në Kosovë bartin kosto vjetore prej 116.3 milion €, e barabartë me 1.6 përqind e PBB-së në kontekstin e pranimit dhe inicimit të pagesave në të gjithë instrumentet e pagesave, me para të gatshme që përfaqëson 1.0 përqind të PBB-së ose mbi gjysmën e kostove totale. Në krahasim, kostoja e kartelës së debitit vlerësohet në 0.2 përqind të PBB-së, transfereret elektronike të kredisë në 0.2 përqind, debitimet direkte elektronike në 0.1 përqind dhe kartelat e kreditit në 0.09 përqind.

Figura 18: Kostot totale vjetore sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2019



Kur zbërthehen përbërësit e kostos së secilit instrument për bizneset, studimi së pari tregon se kostot e barazimeve dhe tarifat për shërbimet e jashtme përbëjnë një pjesë të madhe të kostos totale, duke zënë 70.4 përqind të kombinuara. Në mënyrë të veçantë, ato përfshijnë


kostot e menaxhimit dhe barazimit të fondeve të parave të gatshme; zbrazja dhe balancimi i regjistrave të parave të gatshme / llogarive të parave të gatshme dhe menaxhimi i parave të gatshme; pagesat e transportuesit profesional të parave për transportin e parave të gatshme; dhe pagesa për ofruesit e shërbimeve të pagesave për mbledhjen e pagesave.

IV.3. OFRUESIT E SHËRBIMIT TË PAGESAVE DHE OFRUESIT E INFRASTRUKTURËS SË PAGESAVE

Akterët kryesorë në tregun e pagesave me vlerë të vogël të Kosovës përfshijnë: Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), e cila bënë autorizimin, licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave dhe institucioneve financiare, si dhe është pronari dhe operatori i sistemit të vetëm për shlyerjen bruto në kohë reale (RTGS) dhe sistemit për kliring të automatizuar (ACH); bankat komerciale; institucionet financiare jobankare (përfshirë operatorët e transferimit të parave). Sa i përket kanaleve të qasjes, sipas raportit të fundit (2020) të BQK-së, kishte 497 ATM në vend dhe 13,769 POS terminale.

Kostot e përgjithshme vjetore të anës së ofertës që lidhen me instrumentet e pagesës me vlerë të vogël vlerësohen të jenë 24.9 milion €, afërsisht 0.4 përqind e PBB-së së Kosovës për vitin 2020. Kostot e parave të gatshme përbëjnë gjysmën e të gjitha kostove të anës së ofertës, duke zënë 49.3 përqind.

Figura 19: Kostoja totale vjetore e anës së ofertës sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2019



Kostot e parave të gatshme, afërsisht 0.37 përqind e PBB-së në të gjitha institucionet - bankat komerciale, institucionet financiare jobankare (IFJB) dhe Banka Qendrore. Përafërsisht 20.0 përqind e proceseve që gjenerojnë kosto të parasë së gatshme në këto institucione janë të nënkontraktuara.

Logjistika e vënies së parave të gatshme në dispozicion për klientët në të gjithë vendin përbën një pjesë të madhe të kostove të parave të gatshme: menaxhimi i ATM-ve përfaqëson mbi një të katërtën e të gjitha kostove të parave të gatshme, ndërsa kostot e transportit zënë 15.0 përqind të kostove të parave të gatshme. Kostot e zyrës mbështetëse dhe të sportelit përbëjnë rreth 11.0 përqind.

Sa i përket përbërësve të kostos të lidhura me para të gatshme, rreth 50.0 përqind e të gjitha kostove të parave të gatshme janë në lidhje me logjistikën (dmth. ATM, transporti, siguria). Një pjesë e madhe e koston shoqërohet me aktivitete të tjera që lidhen me Bankën

Qendrore, si dhe kostot e pasqyrës së llogarisë dhe tarifave. Kostot e sportelit dhe të zyres mbështetëse, të cilat kryesisht janë kosto të personelit të bazuara në kohë janë gjithashtu të konsiderueshme pasi që ato zënë rreth 11.0 përqind të totalit.

Komponentë të ndryshëm të koston llogariten si pjesë të ndara të koston totale të secilit instrument. Për shembull, kostot e sportelit janë më të lartat tek kartelat e debitit, ndërsa kostot e sigurisë (kryesisht të sigurimit) zënë mbi tre të katërtat e kostove të debitimit direkt. Me 54.0 përqind të totalit, kostot e TI-së si pjesë e koston totale ishin më të lartat për transfertat e kreditit. Krahasuar me kartelat e kreditit, kartelat e debitit kishin pjesë më të larta të kostove që i atribuohen TI-së, përpunimit të të dhënave dhe tarifave të shlyerjes, ndërsa tarifave e licencimit dhe tarifave të shkëmbimit llogariten si koston më të larta të kartelës së kreditit.

Shumica e kostove që lidhen me kartelat e debitit rrjedhin nga përpunimi i të dhënave (30.0 përqind). Tarifave të shkëmbimit dhe kostot e shlyerjes së bashku gjithashtu zënë një pjesë të madhe të kostove (29.0 përqind). Kostot e sportelit dhe ato të lidhura me TI janë gjithashtu të rëndësishme pasi që së bashku ato zënë 34.0 përqind të kostove. Kostot e tjera të tilla si programet e besnikërisë dhe licencimi janë në nivele shumë më të ulëta prej rreth 2.0 përqind (për ndarjen e detajuar të koston sipas instrumentit nga ana e ofruesit, shih Shtojcën A).

Analiza gjithashtu paraqet indikatorë të koston që lidhen me aktivitete të ndryshme dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me anën e ofertës të pagesave me vlera të vogla në Kosovë.

Figura 20: Indikatorë kostoje të përzgjedhur nga ana e ofertës²³



²³ Kostot e lëshimit të kartelës së debitit dhe kreditit përbëhen nga kostot e prodhimit dhe lëshimit.




V. KOSTOT DHE KURSIMET E EKONOMISË

Analiza lejon nxjerrjen e kostove të ekonomisë duke bashkuar kostot e bartura nga akterët individualë, por duke llogaritur kostot e transferimit (të cilat zakonisht lidhen me aktivitetet e nënkontraktuara dhe përderisa janë kosto për disa akterë, ato janë përfitime për të tjerët dhe kështu ata do të kompensojnë njëra-tjetrën).

Derivimi i koston së ekonomisë së agreguar tregon se çdo vit ekonomia Kosovare mbart kosto ekuivalente me 4.4 përqind të PBB-së, në të gjithë instrumentet e pagesave me vlerë të vogël, akterët, rastet e përdorimit dhe kanalet e qasjes. Më konkretisht, paraja e gatshme zë pjesën më të madhe të të gjitha kostove (60.0 përqind) me afërsisht 2.7 përqind të PBB-së. Të gjithë instrumentet e tjerë përbëjnë pjesë më të vogla të kostove të përgjithshme dhe të PBB-së. Për më tepër, kostot e instrumenteve të bazuara në letër zënë afër 3.0 përqind të PBB-së (ose 68.0 përqind të të gjitha kostove) ndërsa kostot e instrumenteve elektronikë zënë rreth 1.4 përqind të PBB-së (ose 32.0 përqind të të gjitha kostove).

Figura 21: Kostoja totale në ekonomi sipas instrumentit të pagesës si % e PBB-së 2019



Analiza gjithashtu lejon kursime të parashikuara për raste të veçanta përdorimi. Koncretisht, përdoret një normë 50.0 dhe 100.0 përqind e konvertimit (bazuar në metodologjinë) për të nxjerrë kursime të mundshme. Skenarët e zëvendësimit janë ndërtuar në një mënyrë që merr parasysh instrumentet më të besueshëm të pagesave elektronike që do të përdoren për raste të veçanta të përdorimit. Rastet e mëposhtme të përdorimit janë konsideruar duke pasur parasysh që ato përbëjnë llojet më të shpeshta të pagesave: remitancat; pagesa për mallra të qëndrueshme; pagesa për shërbime dhe fatura të shërbimeve; pagat; pagesa të ndihmës sociale nga qeveria.

Kursimet e treguara rrjedhin nga shumëzimi i kursimeve mesatare për transaksion me numrin vjetor të pagesave për katër rastet e ndryshme të përdorimit, nëpër kanalet përkatëse të qasjes, duke përdorur 50.0 dhe 100 përqind të konvertimit. Kursimet më të

mëdha vjetore janë të lidhura me zhvendosjen e pagesave të shërbimeve të bazuara në para të gatshme dhe të faturave të shërbimeve në transferimet elektronike të kreditit, duke çuar në kursime në shumën prej 34.4 milion € dhe 68.7 milion € në vit kur merren parasysh përkatësisht 50.0 përqind dhe 100 përqind e konvertimit. Interesante është se marrësit e remitançave në Kosovë mund të kursejnë deri në 61.4 milion € në vit nëse do të përdorin transferime elektronike të kredisë në vend të parave të gatshme (d.m.th. me 100 përqind të konvertimit). Vëzhgime të tjera përfshijnë:

- Nëse gjysma e dërgesave dhe pranimeve aktuale të remitançave në para të gatshme do të kanalizoheshin përmes kredit transfereve elektronike, konsumatorët do të kursenin rreth 30 milion € në vit. Përveç tarifës së transaksionit, ky vlerësim faktorizon kostot e bazuara në kohë (rreth 60%, si produktiviteti i humbur) për të arritur në pikat fizike të aksesit për të dërguar dhe mbledhur paratë e gatshme

Tabela 5: Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet (me 50 përqind dhe 100 përqind shkallë konvertimi për raste të ndryshme përdorimi)

Skenari i Zëvendësimit / Fusha e Kursimeve	Kursimet: 50% Shkalla e Konvertimit		Kursimet: 100% Shkalla e Konvertimit	
	Euro	% e PBB-se 2019	Euro	% e PBB-se 2019
Remitançat / Transferimi i fondeve				
Para e gatshme > Transfer krediti elektronik	30,717,233	0.44%	61,434,465	0.89%
Produktet				
Para e gatshme > Kredit/Debit Kartelë	20,437,039	0.29%	40,874,079	0.59%
Para e gatshme > Transfer krediti elektronik	33,024,883	0.48%	66,049,765	0.95%
Shërbimet/Komunale				
Para e gatshme > Kredit/Debit Kartelë	21,271,243	0.31%	42,542,486	0.61%
Para e gatshme > Transfer krediti elektronik	34,372,899	0.50%	68,745,799	0.99%



VI. KONKLUSIONE

Analiza e kostos së pagesave me vlerë të vogël sugjeron se përmirësime thelbësore të efikasitetit mund të realizohen në Kosovë nëse pagesat me para të gatshme dhe pagesat tjera të bazuara në letër do të migroheshin në instrumente elektronike me kosto të ulët të pagesave me vlerë të vogël, pjesërisht ose plotësisht. Kostoja aktuale e pagesave të bazuara në letër në nivelin e ekonomisë arrin në rreth 3.0 përqind të PBB-së së vendit, ndërsa kostoja e instrumenteve elektronike të pagesës arrin rreth 1.4 përqind të PBB-së. Në përgjithësi, kursimet mund të arrijnë deri në 1.0 përqind të PBB-së nën një kombinim të skenarëve (p.sh. njëri prej tyre është në 50.0 përqind të remitancave dhe shërbimeve aktuale të bazuara në letër të kalonin në pagesat në mënyrë elektronike).

Qasja e kufizuar në llogaritë bankare ndaj individëve (rreth 40.0 përqind e të rriturve Kosovarë ende nuk kanë qasje në një llogari bankare) në mënyrë të pashmangshme kufizon mundësitë e pagesës. Kjo nxitet gjithashtu nga mungesa e llogarive të parave elektronike, të cilat tani janë duke u funksionalizuar me prezantimin e një Rregulloreje për paratë elektronike (në vitin 2020) nga BQK-ja. Megjithatë, edhe në mesin e mbajtësve të llogarive / kartelave, paraja e gatshme vazhdon të mbizotërojë; vetëm rreth 48.0 përqind e atyre që posedojnë llogari kanë një kartelë debiti në Kosovë.

Përmes zvogëlimit të kostos së transaksionit për shkëmbimit e mallrave dhe shërbimeve,

me një përdorim më efikas të pagesave elektronike, mund të arrihen përfitime të konsiderueshme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Kostot më të ulëta të këtyre shërbimeve mund të kenë potencialin për të rritur shtrirjen e shërbimeve të pagesave jo me para të gatshme dhe elektronike për familjet me të ardhura më të ulëta dhe shitësit e vegjël, duke përmirësuar kështu efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave, pasiqë qasja dhe përdorimi i instrumenteve moderne të pagesave është zgjeruar.

Është e rëndësishme të theksohet se disa zhvillime të hershme nënkuptojnë mundësi për zhvillime të rëndësishme në tregun e pagesave në Kosovë. Që të rritet në mënyrë efikase ekzekutimi i transaksioneve elektronike, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka parashikuar të nxisë dhe të mbështesë implementimin e një sistemi të pagesave të shpejta (instant), nga sektori privat. Përdorimi i përgjithshëm i transfereve elektronike të kreditit, debitimeve direkte dhe kartelave të pagesave kanë dëshmuar përmirësime thelbësore; megjithatë, vëllimi i këtyre transaksioneve është ende mjaft i ulët krahasuar me vëllimin e përgjithshëm të parave të gatshme dhe transaksioneve të tjera të bazuara në letër. Industria, autoritetet qeveritare dhe BQK-ja mund të përdorin provat e forta të efikasitetit të kostos të paraqitura në këtë analizë, shoqëruar me stimuj për të materializuar ndryshimet e nevojshme në terren që do të mbështesin kalimin në pagesa elektronike. Konkretisht, mjetet e mbikëqyrjes mund të përdoren nga

BQK-ja që të mbledhin dhe monitorojnë kostot e lidhura me infrastrukturën, shërbimet dhe instrumentet e pagesave elektronike në baza të rregullta. Kjo është e rëndësishme sepse aspektet e kostos do të jenë të rëndësishme në përpjekjen për të çuar më tej miratimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike.

Vrulli aktual për transaksionet elektronike duhet të ruhet dhe të rritet më tej. Është vërtetë premtuese që pagesat me kartela të debitit kanë pasur normën më të madhe të rritjes midis të gjithë instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël. Sidoqoftë, përdorimi i gjerë i parave të gatshme është ende një pengesë për vrullin e përgjithshëm të pagesave elektronike duke pasur parasysh që ana e ofertes në Kosovë vazhdon të mbajë kosto parash të shoqëruara me 0.2 përqind të PBB-së së vendit 2019 (pothuajse gjysma e të gjitha kostove të anës së ofertes të pagesave me vlera të vogla).

Nga këndvështrimi i tregut, bankat dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave jo bankare duhet të përmbushin në mënyrë efektive një gamë të gjerë të nevojave të transaksioneve të popullatës së synuar, me kosto të arsyeshme. Llogaria rrjedhëse dhe ofertat e produkteve të pagesave mund të kenë nevojë të rishikohen në dritën e përmirësimit të dizajnit të përgjithshëm dhe përbalueshmërisë. Strategjitë e sektorit publik dhe privat duhet të përputhen me nevojat e personave që nuk kanë qasje në shërbime bankare dhe atyre që nuk janë shërbyer sipas nevojave të tyre (si individë ashtu edhe biznese). Duhet të inkurajohen risitë teknologjike dhe të biznesit, të cilat shfrytëzojnë gjithëpërfshirjen dhe ndërveprimin, janë të lehtë për t'u përdorur dhe zvogëlojnë pengesat e ndërtimit të besimit. Për një zëvendësim të rëndësishëm të parasë së gatshme me pagesa elektronike, është e domosdoshme që produktet ekzistuese të pagesave elektronike të ofrohen për më shumë raste të përdorimit, të tilla si tregtia elektronike, transporti publik, dërgesat e brendshme dhe ndërkombëtare, për të përmendur disa.

Për më tepër, inkurajimi i përdorimit të terminaleve POS nga tregtarët është shumë i

rëndësishëm. Në të njëjtën kohë, hapi i parë është pajisja e bizneseve me një numër të mjaftueshëm të terminaleve POS në të gjithë vendin. Në të vërtetë, në nivelin kombëtar shkalla e rritjes së terminaleve POS ka qenë e konsiderueshme, megjithatë ritmi duhet të ruhet dhe të rritet më tej. Sigurimi i ndërveprimit të terminaleve POS gjithashtu do të inkurajojë më shumë tregtarë për të instaluar terminalet POS. Për më tepër, përfituesit duhet të promovojnë përdorimin e pranimit të lehtë përmes infrastrukturës elektronike siç janë kodet QR ose POS me bazë NFC-së (komunikim me qasje të afërt) për të zgjeruar përdorimin.

Prezantimi i metodave të reja të pagesave elektronike, të tilla si llogaritë e transaksioneve, pagesa të menjëhershme, paraja elektronike dhe transferime të parave elektronike të kanalizuar përmes zgjidhjeve inovative, gjithashtu mund të ketë rëndësi për tregun e pagesave me vlerë të vogël të Kosovës, në zhvendosjen e pagesave me vlerë të vogël nga paratë e gatshme, të cilat janë më të kushtueshme, në instrumentet e pagesave elektronike më pak të kushtueshme.

Për më tepër, duke pasur parasysh koston e lartë të trajtimit të parave të gatshme, automatizimi i menaxhimit të parave të gatshme, veçanërisht për bizneset dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave, do të jetë i rëndësishëm në mënyrë që të zvogëlohen disa nga joefikasitetet aktuale. Kjo do të nënkuptonte vendosjen e zgjidhjeve të reja teknologjike, ndër të tjera, për numërimin, klasifikimin dhe shpërndarjen e parave fizike.

Në përgjithësi, edhe pse paraja e gatshme mbizotëron ende dhe është mjaft e kushtueshme për Kosovën, ka shenja premtuese të novacionit dhe largimit nga paratë e gatshme. Industria dhe autoritetet përkatëse duhet të përdorin provat e forta të efikasitetit të kostos të paraqitura në këtë analizë, shoqëruar me stimuj për të materializuar ndryshimet e nevojshme në terren që do të mbështesin kalimin në pagesa elektronike.

SHTOJCA

Figura 22: Gjinia (Përqindja e të anketuarve)




Figura 23: Vendbanimi (përqindja e të anketuarve)




Figura 24: Niveli i arsimimit të të anketuarve




Figura 25: Të anketuarit sipas llojit të punësimit





Figura 26: Të anketuarit sipas grupmoshës



Shpërndarja e mostrës së biznesit ²⁴

Tabela 6: Shpërndarja e mostrës së biznesit sipas industrisë, madhësisë së biznesit dhe rajonit administrative

Industria	Shpërndarja e mostrës	Madhësia e Biznesit	Shpërndarja e mostrës	Rajoni Administrativ	Shpërndarja e mostrës
Ndërtim & Prodhim	32%	Biznes mikro (1-9 punëtor)	69%	Prishtinë	30%
		Biznes i vogël (10-49 punëtor)	10%	Prizren	19%
				Ferizaj	18%
Shërbime	24%	Biznes i mesëm (50 – 249 punëtor)	12%	Gjilan	10%
				Mitrovica	9%
Tregti	44%	Biznes i madh (250 punëtor e më shumë)	9%	Gjakova	8%
				Peja	6%
Totali	100%	Totali	100%	Totali	100%

Tabela 7: Shpërndarja e mostrës së biznesit sipas komunave

Komunat	Shpërndarja e mostrës	Komunat	Shpërndarja e mostrës
Prishtinë	21%	Rahovec	1%
Prizren	15%	Graçanica	1%
Ferizaj	15%	Skënderaj	1%
Gjilan	9%	Obiliq	1%
Gjakovë	6%	Istog	1%
Vushtrri	4%	Hani i Elezit	1%
Peje	4%	Dragash	1%
Podujevë	4%	Shtime	1%
Suharekë	3%	Viti	1%
Fushë Kosovë	2%	Malishevë	1%
Lipjan	2%	Leposaviq	1%
Kaçanik	2%	Klinë	1%
Deçan	2%	Kamenicë	1%
Mitrovicë	2%	Gjithsej	100%

²⁴ Nga 192 biznese që u përgjigjen, 6 prej tyre janë nga bizneset e transportit. Sidoqoftë, ato janë larguar nga analiza përfundimtare e mostrës pasi që pothuajse të gjitha variablat e tyre kryesorë të rëndësishëm për këtë studim janë koduar si mos përgjigje ose probleme të fushave tjera. Përveç kësaj, duke marrë parasysh numrin e vogël të bizneseve nga industria e ndërtimit dhe prodhimit, ndërtimi dhe prodhimi janë bashkuar si "Ndërtim & Prodhim"

Ndarja e kostove për bizneset sipas instrumentit të pagesës

Tabela 8: Ndarja e komponentëve të kostos së parasë së gatshme

Kostot e parasë së gatshme	
Komponentët e kostove	Përqindja
Menaxhimi dhe rikonsilimi i fondeve në parave të gatshme	20.60%
Pagesa për transportuesit profesional për transportim të parasë së gatshme dhe sigurimit	18.70%
Pagesa e ofruesve të shërbimeve të pagesave për mbledhjen e pagesave në emër tuaj	16.80%
Zbrazja dhe balancimi i regjistrave të parave të gatshme / llogarive të parave të gatshme dhe menaxhimi i parave të gatshme të zyrës mbështetëse	14.30%
Tarifat për bankat për depozitimin e parave të gatshme	7.60%
Transporti ²⁵	5.10%
Mirëmbajtja e një llogarie bankare	3.80%
Mirëmbajtja e një kasaforte	3.20%
Mirëmbajtja e regjistrave të parave të gatshme, makinave për vërtetimin e kartëmonedhave dhe / ose kartelave	2.70%
Kontrollimi i gjendjes së llogarisë bankare	2.30%
Humbjet e biznesit për shkak të mashtrimit ²⁶ ose vjedhjes dhe kostove të sigurimit	2.20%
Përgatitja e arkës / terminaleve të kartelave para hapjes së dyqanit	1.60%
Verifikimi i vlefshmërisë dhe vërtetimit të kartëmonedhës	0.70%
Ndërrimi i rotullave të letrës në arka	0.40%
Totali	100%

Tabela 9: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së debitit

Kostot e Kartelës së Debitit	
Komponentët e kostove	Përqindja
Pagesa tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankave) për pranimin e kartelave të debitit	63.90%
Kostot e telekomunikimit të ngarkuara për lidhjen në internet të terminaleve të kartelave ose parase elektronike	11.00%
Shtypja, rikonsilimi, kontrollimi, regjistrimi i pasqyrave ditore të faturave dhe barazimi i llogarive shoqëruese	8.90%
Kostot e biznesit (p.sh. kostot e transaksionit, tarifave shtesë) të ngarkuara për blerjet duke përdorur kartelën e debitit	8.00%
Përdorimi i bankingut online	3.80%
Mirëmbajtja e një llogarie bankare	1.90%
Kontrollimi i gjendjes së llogarisë bankare	1.20%
Humbjet e biznesit për shkak të mashtrimit ose vjedhjes dhe kostove të sigurimit	1.00%
Ndërrimi i rotullave të letrës në terminale të kartelave	0.30%
Total	100%

²⁵ Kostoja mesatare vjetore e punonjësve për të shkuar dhe ardhur nga banka ose ATM-ja më e afërt me qëllim tërheqjen e parave, depozitimin e shitjeve, kryerjen e pagesave, etj. Kostoja monetare llogaritet duke përdorur pagën mesatare të arkëtarit si prokurë. Bazuar në analizën e mostrës, paga mesatare e arkëtarit për minutë është 0,03 euro (1,77 euro / orë), me një supozim tipik prej 5 ditësh pune në javë dhe 8 orë në ditë.

²⁶ Humbjet e biznesit për shkak të parave të falsifikuara, vjedhjes së parave të gatshme dhe/ose gabimeve/mospërputhjeve në gjendjen e kasave dhe llogarinë së parave të gatshme.

Tabela 10: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së kreditit

Kostot e Kartelës së Kreditit	
Komponentët e kostove	Përqindja
Pagesa tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankave) për pranimin e kartelave të kreditit	47.20%
Kostot e biznesit (p.sh. kostot e transaksionit, tarifit shtesë) të ngarkuara për blerjet duke përdorur kartelen e kreditit	21.80%
Kostot e telekomunikimit të ngarkuara për lidhjen në internet të terminaleve të kartelave ose parase elektronike	12.30%
Shtypja, rikonsilimi, kontrollimi, regjistrimi i pasqyrave ditore të faturave dhe barazimi i llogarive shoqëruese	10.00%
Përdorimi i bankingut online	4.40%
Mirëmbajtja e një llogarie bankare	2.20%
Kontrollimi i gjendjes së llogarisë bankare	1.40%
Ndërrimi i rrotullave të letrës në terminale të kartelave	0.40%
Humbjet e biznesit për shkak të mashtrimit ose vjedhjes dhe kostove të sigurimit	0.30%
Total	100%

Tabela 11: Ndarja e komponentëve të kostos së transferit të kreditit

Kostot e Kredit Transferit	
Komponentët e kostove	Përqindja
Pagesa tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankave) për pranimin e transferit të kreditit	51.60%
Përdorimi i bankingut online	19.90%
Mirëmbajtja e një llogarie bankare	10.00%
Humbjet e biznesit për shkak të mashtrimit ose vjedhjes dhe kostove të sigurimit	9.10%
Kontrollimi i gjendjes së llogarisë bankare	6.10%
Kostot e biznesit (p.sh. kostot e transaksionit, tarifit shtesë) të ngarkuara për blerjet duke përdorur transferrin e kreditit	3.20%
Total	100%

Tabela 12: Ndarja e komponentëve të kostos së debitimit direkt

Kostot e Debitimit Direkt	
Komponentët e kostove	Përqindja
Pagesa tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (bankave) për pranimin e debitimit direkt	68.50%
Përdorimi i bankingut online	14.10%
Mirëmbajtja e një llogarie bankare	7.10%
Kontrollimi i gjendjes së llogarisë bankare	4.30%
Kostot e biznesit (p.sh. kostot e transaksionit, tarifit shtesë) të ngarkuara për blerjet duke përdorur debitimin direkt	3.80%
Humbjet e biznesit për shkak të mashtrimit ose vjedhjes dhe kostove të sigurimit	2.20%
Total	100%

Ndarja e kostove të anës së ofertës sipas instrumenteve të pagesës

Tabela 13: Ndarja e komponentëve të kostos së parasë së gatshme

Kostot e parasë së gatshme	
Përqindja e nënkontraktuar	21%
Komponentët e kostove²⁶	Përqindja
Administrative	34.00%
ATM	29.00%
Transport	15.00%
Sigurim	11.00%
Sportel	7.00%
Zyra mbështetëse	4.00%
TI	2.00%
Total	100%

Tabela 14: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së debitit

Kostot e Debit Kartelës	
Përqindja e nënkontraktuar	14%
Komponentët e kostove²⁷	Percent
Përpunimi i të dhënave	30.00%
Gjendja	18.00%
Sporteli	17.00%
TI	17.00%
Tarifë Shkëmbimi	11.00%
Sigurimi	4.00%
Licensimi	2.00%
Administrative të tjera	2.00%
Programe te besnikërisë	1.00%
Total	100%

²⁶ Ndarja e komponentëve për para të gatshme përbëhet nga kostot e mëposhtme: ATM - mirëmbajtja dhe tarifat e këmbimit. Zyra mbështetëse - shpenzime komerciale për përpunimin e parave të gatshme; kostot e stafit të kasafortës së Bankës Qendrore. Sporteli - kostot e personelit të bankës komerciale për procesimin e transaksioneve, hapjen dhe mbylljen e llogarive; Kostot e stafit të IFJB për shpërndarjen dhe mbledhjen e parave të gatshme. Kostot e sigurisë - mirëmbajtja e kasafortës, sigurimi, humbja dhe parandalimi i mashtrimit për bankat komerciale, IFJB-të dhe banka qendrore. TI - lidhja e rrjetit, mirëmbajtja e pajisjeve dhe programeve dhe kostot e sistemit bankar të Bankës Qendrore. Transporti - të gjitha kostot e transportit për bankat komerciale, IFJB-të dhe Bankën Qendrore. Të tjera – kostot për kërkesa dhe gjendje nga bankat komerciale; shtypja, reklamimin dhe tarifat e IFJB-vë.

²⁷ Ndarja e komponentëve për kartat e debitit përbëhet nga kostot e mëposhtme: Sporteli - prodhimi, lëshimi dhe transporti. TI – Sistemi TI i kartelave dhe kostot e POS. Siguria - kostot e sigurimit, humbjes dhe parandalimit të mashtrimit. Të tjera - kostot e kerkesave, gjendjes dhe tarifave.

Tabela 15: Ndarja e komponentëve të kostos së kartelës së kreditit

Kostot e Kredit Kartelës	
Përqindja e nënkontraktuar	16%
Komponentët e kostove²⁸	Përqindja
Tarifë Shkëmbimi	20.00%
Sporteli	18.00%
Përpunimi i të dhënave	17.00%
Gjendja	13.00%
Licensimi	12.00%
IT	10.00%
Administrative të tjera	5.00%
Sigurimi	4.00%
Programe te Besnikërisë	1.00%
Total	100%

Table 16: Ndarja e komponentëve të kostos së transferit të kreditit

Kosotot e transferit të kreditit elektronik	
Përqindja e nënkontraktuar	8%
Komponentët e kostove²⁹	Përqindja
IT	54.00%
Administrative të tjera	30.00%
Sporteli	8.00%
Përpunimi	5.00%
Sigurimi	3.00%
Total	100%

Tabela 17: Ndarja e komponentëve të kostos së Debitimit Direkt

Kostot e Debitimit Direkt Elektronik	
Përqindja e nënkontraktuar	1%
Komponentët e kostove³⁰	Përqindja
Administrative	30.00%
IT	28.00%
Sigurimi	20.00%
Përpunimi	15.00%
Sporteli	7.00%
Total	100%

²⁸ Ndarja e komponentëve për kartat e kreditit përbëhet nga kostot e mëposhtme: Sporteli - prodhimi, lëshimi dhe transporti. TI - Sistemi TI i kartelave dhe kostot e POS. Siguria - kostot e sigurimit, humbjes dhe parandalimit të mashtrimit. Të tjera - kostot e kërkesave, gjendjes dhe tarifave.

²⁹ Ndarja e komponentëve për transfertat e kredisë përbëhet nga kostot e mëposhtme: Sporteli - kërkesat lidhur me transfertat e kreditit. Siguria - kostot e sigurimit, humbjes dhe parandalimit të mashtrimit. Përpunimi - tarifet e bankave tregtare të paguara për autorizim, kliring, hyrjen në rrjet dhe tarifet e shkëmbimit; kostot e përpunimit të bankës qendrore. Të tjera - kostot e softuerit të Bankës Qendrore; arkivimi i bankës komerciale dhe kostot e kërkimit të kanalit në distancë.

³⁰ Ndarja e komponentëve për debitimin direkt përbëhet nga kostot e mëposhtme: Sporteli - kërkesat lidhur me debitë direkte. Siguria - kostot e sigurimit, humbjes dhe parandalimit të mashtrimit. Përpunimi - tarifet e bankave tregtare të paguara për autorizim, kliring, hyrjen në rrjet dhe tarifet e shkëmbimit; kostot e përpunimit të bankës qendrore. Të tjera - kostot e softuerit të Bankës Qendrore; arkivimi i bankës komerciale dhe kostot e kërkimit të kanalit në distancë.

